



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Deklaratat përmbyllëse në gjykimin e Pjetër Shalës u bënë këtë javë. Të hënën, Prokuroria bëri deklaratën e vet, vijuar nga Mbrojtësi i Viktimave të martën paradite. Mbrojtja përfundoi deklaratën e vet përmbyllëse të mërkurën, pas së cilës palët dhe pjesëmarrësit u përgjigjën dhe komentuan mbi parashtrimet e njëri-tjetrit. Pas kësaj u bënë parashtrime në lidhje me çështjen e zhdëmtimeve në rast të një vendimi fajësie, dhe z. Shala iu drejtua gjykatës.

Kryegjykatësja e deklaroi çështjen gjyqësore të mbyllur. Në përputhje me Rregulloren, gjykatësit e Trupit Gjyqësor mblidhen për të bërë kuvendime konfidenciale për marrjen e vendimit të gjykimin në lidhje me akuzat në aktakuzë. Vendimi i gjykimin shqiptohet brenda nëntëdhjetë ditësh pas mbylljes së çështjes, përveçse kur rrethanat e saj kërkojnë zgjatje të mëtejshme të këtij afati.

Në çështjen kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës, Paneli i Apelit më 12 prill rrëzoi apelin e z. Haxhi Shala kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për vazhdimin e paraburgimit të tij.

Po në këtë çështje, versioni i redaktuar publik i vendimit mbi rishikimin e paraburgimit të Ismet Bahtijarit doli javën e kaluar. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vazhdoi paraburgimin e z. Bahtijari, duke konstatuar se, megjithëse kushtet e propozuara nga Mbrojtja mund të zvogëlonin mjaftueshëm rrezikun e arratisjes, ato nuk do të mund të kufizonin aftësinë e të akuzuarit për të penguar ecurinë e procesit të Dhomave të Specializuara dhe për të kryer vepra penale të tjera.

Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u shpreh se z. Bahtijari do të kishte motivin, mjetet dhe mundësinë për t'i bërë trysni Dëshmitarit 1 që të mos marrë pjesë në proces, apo të manipulojë provat. Gjykatësi gjithashtu konstatoi se paraburgimi i z. Bahtijari vazhdon të jetë i arsyeshëm dhe proporcional.

Po në këtë çështje, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i miratoi Mbrojtjes së Bahtijarit zgjatje të afatit deri më 19 prill 2024 për dorëzimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme për të kërkuar ndihmë juridike në Zyrën Administrative të Dhomave të Specializuara.

Më 15 prill 2024, Trupi Gjyqësor, në vendime më vete për secilin, vazhdoi paraburgimin e Kadri Veselit dhe Hashim Thaçit, dhe në lidhje me të dy të akuzuarit konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku se do të pengojnë procesin dhe do të kryejnë vepra penale të tjera, dhe se ky rrezik mund të zvogëlohet vetëm me anë të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHSK-së, përfshirë masat e urdhëruara rishtazi nga Trupi Gjyqësor.





Në këtë kontekst, në rastin e z. Thaçi Trupi Gjykues përsëriti konstatimet e mëparshme se duket se z. Thaçi u tregoi vizitorëve informacion të nxjerrë gjatë dëshmime të dëshmitarëve të mbrojtur dhe se dokumentet sugjerojnë se ai i dha një vizitori jo të privilegjuar udhëzime për t'ia kaluar një dëshmitari të ardhshëm të ZPS-së në lidhje me mënyrën dhe përmbajtjen e dëshmisë që do të jepte ai dëshmitar.

Më 15 prill, Trupi Gjykues në këtë çështje gjyqësore hodhi poshtë kërkesën e Veselit për leje për apelimin e një vendimi mbi pranimin e disa provave. Trupi Gjykues konstatoi se Mbrojtja e Veselit nuk vërtetoi ndonjë padrejtësi të shkaktuar nga pranimi i provave dhe vuri në dukje se kishte dëgjuar parashtrimet e të dy palëve para se të merrte vendimin.

Seanca gjyqësore e ardhshme në çështjen Thaçi dhe të tjerët është caktuar për të hënë, 22 prill, duke filluar nga ora 09:00 paradite.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

